



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË MINIERAVE

Nr. 4229/2 Prot.

Tiranë, më 15/6 /2015

Drejtuar: Z. EDUARD AHMETI,

DREJTOR I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK.

TIRANË

Lënda: Njoftim për korrigjim në Ftesën për Ofertë Nr. 4229/1 prot. datë 28.05.2015.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, mbështetur në Nenin 129 të Kodit të Procedurës Administrative, Ligjin Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.320, datë 21.04.2011 "Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese" njofton, korrigjimin e DSPK-ve të publikuara me **Ftesën për Ofertë Nr. 4229/1 prot. datë 28.05.2015**, në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 21, datë 01.06.2016 si dhe në faqen zyrtare të MEI. Konkretisht njoftohet:

- Saktësimi i numrit të zonës 378, Objekti "Povel", Qarku Fier, lloji i mineralit gëlqeror, veprimtaria shfrytëzim. Për shkak të një gabimi material, në ftesën për ofertë Nr. 4229/1 prot. datë 28.05.2015, Nr. i zonës është shpallur gabimisht 387. Për sa me sipër, të dhënat e zonës Nr.378 do të jenë sipas përcaktimeve të aneksit Nr. 1, (tabela bashkëlidhur).

Lutemi botimin e këtij njoftimi.
Bashkëlidhur CD që përmban këtë njoftim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

MINISTRI

DAMIAN GJINURI



ANEKSI I

Të dhëna për zonën minerare konkurruese Nr. 378 të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2011, që shpallet në procedurë konkurruese për të drejtën e aplikimit për një leje minerare.

Zona minerare Nr. 378 (Objekti Povel), Qarku Fier, e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2011, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nr. 588, datë 02.08.2011 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2011”, e përfshirë në qarkun Fier.

Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese Nr. 378

Emri i objektit minerar	Lloji i Mineralit	Rezervat në ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Sipërfaqja e zonës km ²	Pika	X	Y
Objekti Povel, Qarku Fier	Gëlqeror	1 300 000	96 % CaCO3	Shfrytëzim	0.065	1	4488250	4394400
						2	4488450	4394570
						3	4488500	4394700
						4	4488370	4394800
						5	4488310	4394650
						6	4488120	4394550

Kriteret minimale për zonën konkurruese Nr. 378

Emri i objektit minerar	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Vlera minimale e sipërfaqes km ²	Sasia minimale e prodhimit, ton ose m ³ /vit	Vlera minimale e investimit (pa TVSH) mln leke/ për prodhimin vjetor minimal
Objekti Povel, Qarku Fier	Shfrytëzim	0.02	10 000	21

Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare Nr. 378

